



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Integrimin Europian

PROCESVERBAL

Tiranë, më 08.07.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Senida Mesi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për mbrojtjen civile”.
2. Të tjera.

Marrin pjesë:

Senida Mesi, Musa Ulqini, Ilir Pendavinji, Taulant Balla, Mirela Kumbaro, Ralf Gjoni, Aurora Mara, Andrea Marto, Arben Kamami, Klodiana Spahiu

Mungojnë:

Rudina Hajdari, , Fatmir Velaj, , Suzana Topi, Sadri Abazi, Eglantina Gjermani, Ilir Beqja.

Të ftuar:

Petro Koçi - Zëvendësministër i Mbrojtjes

Haki Çako - Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile

Ismail Shehu - Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standartizimit dhe Harmonizimit të

Akteve Rregullatore, në Ministrinë e Mbrojtjes

Maksimiljan Dhima - Drejtor i Planifikimit dhe Koordinimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile

HAPET MBLEDHJA

Senida Mesi – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Integritetit Europian.

Sot në rendin e ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për mbrojtjen civile”.

Të ftuar për shqyrtimin e projektligjit kemi zotin Petro Koçi, zëvendësministër i Mbrojtjes, zotin Haki Çako, drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, zotin Ismail Shehu, drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore në Ministrinë e Mbrojtjes dhe zotin Maksimiljan Dhima, drejtor i Planifikimit dhe Koordinimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile.

Zoti Zëvendësministër, ju falënderoj!

Pa humbur kohë, po i kaloj fjalën zëvendësministrit në lidhje me prezantimin e projektligjit. Më pas kolegët deputetë kanë të drejtë për të bërë pyetje dhe diskutime në lidhje me projektligjin.

Faleminderit!

Petro Koçi – Faleminderit!

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Anëtarë të Komisionit të Integritetit Europian,

Së pari, më lejoni të them se ka një moskoordinim ndërmjet komisioneve, sepse ndërkohë ne ishim në një mbledhje të Komisioni i Ligjeve, duke e ndërprerë diskutimin atje për të ardhur këtu. Kështu që do t’ju lutesha që të investohemi sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë që t’i përgjigjemi edhe axhendës së atij komisioni.

Projektligji “Për mbrojtjen civile”, në raport me fokusin e komisionit tuaj, është një nga projektligjet, që na përfaqëson të paktën me katër direktiva të Bashkimit Europian. Ky projektligj është shumë i rëndësishëm, sepse rishikon në mënyrë themelore çështjet e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë. Aktualisht në fuqi, siç ju e dini, kemi ligjin “Për emergjencat civile”, por duket qartazi se ky ligj tashmë nuk mund ta përballojë dinamikën e zhvillimeve në këtë fushë dhe nuk e angazhon potencialin e shoqërisë dhe shtetit për t’i zvogëluar risqet në mënyrën e duhur.

Tashmë, siç ju e dini, fatkeqësitë dhe pasojat e tyre janë një axhendë globale. Kështu që është detyrë e shtetit dhe e shoqërisë për t'i zvogëluar, sa të jetë e mundur, risqet që vijnë nga fatkeqësi të ndryshme. Ligji, që kemi në dorë, praktikisht, parashikon ngritjen e një sistemi, pothuajse gjithëpërfshirës, të shoqërisë dhe të shtetit për të zvogëluar risqet që vijnë nga fatkeqësitë. Ky është qëllimi kryesor i ligjit.

Për sa u përket objektivave, ato janë: identifikimi i saktë; vlerësimi periodik i riskut dhe monitorimi i tij, duke zbutur pasojat negative të fatkeqësive, si dhe duke investuar në parandalimin e risqeve; forcimi i sistemit të mbrojtjes civile, nëpërmjet krijimit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, por edhe të agjencive në nivel vendor dhe lokal, praktikisht, në nivelin e prefekturave dhe bashkive. Ky projektligj nuk i cenon aktualisht kompetencat e pushtetit vendor në këtë fushë, por, siç e thashë, në fillim synon ngritjen e një sistemi gjithëpërfshirës të shoqërisë për të përballuar dhe për të zvogëluar risqet.

Nga pikëpamja e integritetit, siç e thashë në fillim, përfron legjislacionin tonë me katër direktiva. Gjithashtu, dua të them se përputhet me formatin “Sendai” të Kombeve të Bashkuara për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive dhe, nga ana tjetër, garanton që Shqipëria të integrohet në mekanizmin europian të zvogëlimit të fatkeqësive.

Besoj se këto janë gjërat kryesore që mund të thuhet në një prezantim të shkurtër të këtij projektligji përballë Komisionit të integritetit Europian të Kuvendit të Shqipërisë.

Faleminderit!

Senida Mesi – Faleminderit, zoti Zëvendësministër!

Nga Drejtoria e Përafrimit të Legjislacionit, zoti Kasneci, do të doja të shprehnit mendimin tuaj dhe nëse ky projektligji përafrohet me legjislacionin e BE-së me direktivat përkatës dhe ku është e nevojshme ndryshimi dhe ndërhyrja.

Faleminderit!

Dedë Kasneci – Faleminderit, zonja zëvendëskryetare!

Sikurse u prezantua edhe nga zëvendësministri, projektligji “Për mbrojtjen civile” një nga qëllimet e tij ka përafrimin me legjislacionin përkatës të BE-së në fushën e mbrojtjes civile.

Konkretisht, korpusi ligjor i BE-së, që është përafuar nga ky projektligj, përbëhet nga 4 direktiva dhe 2 vendime. Ne e kemi analizuar në shërbimin tonë dhe kemi paraqitur dy korrigjime: njëri lidhet me shënimin në fund të faqes, me titullin e projektligjit, lidhur me CELEX-in, si dhe

tjetri lidhet me pikën 13 dhe ka të bëjë me nenin 3, që lidhet me një përkufizim. Për efekt të kohës ne kemi dakordësuar edhe me përfaqësuesit e qeverisë.

Faleminderit!

Senida Mesi – Faleminderit!

A ka pyetje apo diskutime nga kolegët deputetë? Nuk ka.

Atëherë, duke qenë se ky projektligj do të shqyrtohet nga ana teknike dhe me detaje nga komisioni përgjegjës, në kuadër të observimit dhe të raportit që ka sjellë Drejtoria përkatëse e Përafrimit të Legjislacionit, do t'ju lutesha që t'i merrni parasysh të gjitha ndryshimet.

Atëherë, kalojmë në procesin e votimit.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me ndryshimin e nenit 3, që sapo e përmendi zoti Kasneci, si dhe me komentin e tij në faqen e parë të projektligjit? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Ju lutem, zoti Zëvendësministër, kam vetëm një koment në lidhje me takimin e radhës. Komisioni ynë do të diskutojë edhe projektligje të tjera, siç është projektligji “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”. Nga ana e Sekretariatit Teknik të Kuvendit ka ardhur një propozim që këtë projektligj ta shqyrtojmë ditën e mërkurë, në datën 10.07.2019, ora 12:00.

A jeni dakord? Në rregull!

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA